

# GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

P. No. 184/15

08 gusht 2016

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, me Trupin gjykues i përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it, Katrien Gabriël Witteman, Kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarët e EULEX-it, Iva Niksic dhe Rene Van Veen, si anëtarë të Trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it, Chiara Tagliani, si zyrtare regjistruese, në çështjen penale kundër:

**X. K. , aktualisht në paraburgim që nga 07 tetori 2015;**

I akuzuar me anën e Aktgjykimit të Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, data, 09 nëntor 2015, me numrin PPS 08/09, për kryerjen e veprave penale të:

“**Krimeve të luftës kundër popullatës civile**”, nën **akuza të shumta**, e përcaktuar dhe e dënueshme me nenet 22 dhe 142, të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), aktualisht e dënueshme sipas neneve 31 dhe 152, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)<sup>1</sup>, në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5, Protokollit II Shtesë, 1977;

dhe,

---

<sup>1</sup> Kodi nr. 04/L-082;

**“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, e përcaktuar dhe e dënueshme me nenin 374, paragrafin 1, në lidhje me nenin 120, pikën 38, të KPRK-së;**

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesor, të gjitha të hapura për publikun, me datat, 18 mars 2016, 11, 12, 13, 18, 19, 20 dhe 25 prill 2016, 13, 23, 24, 25 dhe 30 maj 2016, 07, 08, 12, 14 korrik 2016 dhe 02 dhe 04 gusht 2016, në praninë e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës , të të akuzuarit, **X. K.** dhe të avokatëve të tij mbrojtës, H. M. dhe M.V.;

Pas shqyrtimit dhe votimit në pajtim me nenin 357, të KPK-së, më 05 gusht 2016;

në pajtim me nenet 362, 363, 364, 365, 366, 450, 451 dhe 453, të KPK-së.

Shpall sikurse më poshtë:

AKTGJYKIM

I

## PIKA I E AKTAKUZËS:

“Krimeve të luftës kundër popullatës civile”, nën akuza të shumta, e përcaktuar dhe e dënueshme me nenet 22 dhe 142, të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), aktualisht e dënueshme sipas neneve 31 dhe 152, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5, të Protokollit II Shtesë, 1977, efektive në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe në çdo kohë të rëndësishme për aplikimin aktual, e kryer në qendrat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të vendosura në K. dhe C. (Shqipëri).

**Nën Pikën 1 të Aktakuzës: Vrasje si krim i luftës kundër popullatës civile;**

I pandehuri, X. K. është shpallur i PAFAJSHËM, sepse nuk është dëshmuar se:

I pandehuri si anëtar i UÇK-së duke mbajtur një pozicion të lartë në Qendrën e UÇK-së, në K. (Shqipëri), në bashkëveprim me anëtarë të tjerë të UÇK-së, kanë vrarë A. B. deri sa ai në mënyrë ilegale mbahej në Kampin e Kukësit, duke e rrahur dhe shtënë mbi të, në K. (veriu i Shqipërisë), me datën 04 apo 05 qershori, 1999.

Prandaj, në pajtim me nenin 364, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3, të KPK-së, i akuzuari, **X. K.** lirohet nga kjo pikë e Aktakuzës.

**Nën pikën 2 të Aktakuzës: Mbajtje ilegale si krim i luftës kundër popullatës civile;**

I pandehuri, **X. K.**                   është shpallur **FAJTOR**, sepse është dëshmuar se:

I pandehuri si anëtar i UÇK-së, në bashkëveprim me S. G.                   dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së, kishin arrestuar dhe në mënyrë ilegale i kanë mbajtur dëshmitarët, A, B, C, D, E, F, H, K, A. B. dhe civilë të tjerë të panjohur në një qendër të tillë për një kohë të gjatë, në K. (veri të Shqipërisë), gjatë muajve prill, maj dhe përgjatë mesit të qershorit të vitit 1999.

Duke vepruar kështu, i pandehuri **X. K.**                   ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të Krimeve të luftës kundër popullatës civile, e dënueshme me nenet 22 dhe 142, të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), aktualisht e dënueshme sipas neneve 31 dhe 152, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5, të 1977 Protokollit II Shtesë, efektive në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe në çdo kohë të rëndësishme për aplikimin e tanishëm.

**Nën pikën 3 të Aktakuzës: Kushte çnjerëzore si krime lufte kundër popullatës civile;**

I pandehuri, **X. K.**                   shpallet **FAJTOR**, sepse është dëshmuar se:

I pandehuri si anëtar i UÇK-së, në bashkëveprim me S. G.                   dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së i kanë mbajtur dëshmitarët, A, B, C, D, E, F, H, K, A. B.                   dhe civilë të tjerë të panjohur në një qendër të tillë nën kushte çnjerëzore (qeli të vogla, me mungesë të ujtit, të ushqimit, të pastërtisë, të ajrit dhe të qasjes në kurime mjekësore), në K. (veri të Shqipërisë), gjatë muajve prill, maj dhe përgjatë mesit të qershorit të vitit 1999.

Duke vepruar kështu, i pandehuri **X. K.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të Krimeve të luftës kundër popullatës civile, e dënueshme me nenet 22 dhe 142, të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), aktualisht e dënueshme sipas neneve 31 dhe 152, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5, të 1977 Protokollit II Shtesë, efektive në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe në çdo kohë të rëndësishme për aplikimin e tanishëm.

**Nën pikën 4 të Aktakuzës: Torturë si krime lufte kundër popullatës civile;**

I pandehuri, **X. K.** shpallet **FAJTOR**, sepse është dëshmuar se:  
I pandehuri si anëtar i UÇK-së, në bashkëveprim me S. G. dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së i kanë torturuar dëshmitarët, A, B, C, H, dhe A. B. duke i rrahu ata deri ne humbjen e vetëdijes me shkopinj në K. (veri të Shqipërisë), në një datë të panjohur në maj të vitit 1999.

Duke vepruar kështu, i pandehuri **X. K.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të Krimeve të luftës kundër popullatës civile, e dënueshme me nenet 22 dhe 142, të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), aktualisht e dënueshme sipas neneve 31 dhe 152, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5, të 1977 Protokollit II Shtesë, efektive në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe në çdo kohë të rëndësishme për aplikimin e tanishëm.

**Nën pikën 5 të Aktakuzës: Shkelje të integritetit trupor apo të shëndetit si krime lufte kundër popullatës civile;**

I pandehuri, **X. K.** shpallet **FAJTOR**, sepse është dëshmuar se:  
I pandehuri si anëtar i UÇK-së, në bashkëveprim me S. G. dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së i kanë shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e dëshmitarëve, A, B, C, D, E, F, H, K, dhe A. B. duke i rrahu ata vazhdimisht apo duke i urdhëruar të tjerët që ta bëjnë atë në K. (veri të Shqipërisë), gjatë muajve prill, maj dhe përgjatë mesit të qershorit të vitit 1999.

Duke vepruar kështu, i pandehuri **X. K.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të Krimeve të luftës kundër popullatës civile, e dënueshme me nenet 22 dhe 142,

të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), aktualisht e dënueshme sipas neneve 31 dhe 152, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5, të 1977 Protokollit II Shtesë, efektive në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe në çdo kohë të rëndësishme për aplikimin e tanishëm.

**Nën pikën 6 të Aktakuzës: Mbajtje ilegale si krim lufte kundër popullatës civile;**

I pandehuri, **X. K.** shpallet **FAJTOR**, sepse është dëshmuar se:

I pandehuri si anëtar i UÇK-së në bashkëveprim me anëtarë të tjerë të UÇK-së në mënyrë të paligjshme kanë mbajtur dëshmitarët K, L, M dhe N, në kampin e C. (Shqipëri e veriut) gjatë muajve prill, maj dhe përgjatë mesit të qershorit të vitit 1999, dhe në mënyrë të paligjshme kanë mbajtur dëshmitarët L dhe N në një garazh në P. në ditë të panjohura në muajin qershor të vitit 1999.

Duke vepruar kështu, i pandehuri **X. K.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të Krimeve të luftës kundër popullatës civile, e dënueshme me nenet 22 dhe 142, të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), aktualisht e dënueshme sipas neneve 31 dhe 152, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5, të 1977 Protokollit II Shtesë, efektive në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe në çdo kohë të rëndësishme për aplikimin e tanishëm.

**Nën pikën 7 të Aktakuzës: Shkelje të integritetit trupor apo të shëndetit si krime lufte kundër popullatës civile,** e dënueshme me nenet 22 dhe 142, të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), aktualisht e dënueshme sipas neneve 31 dhe 152, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5, të 1977 Protokollit II Shtesë, efektive në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe në çdo kohë të rëndësishme për aplikimin e tanishëm,

sepse i pandehuri në bashkëveprim me anëtarë të tjerë të UÇK-së si anëtar i UÇK-së ka shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e një individi të panjohur nga P. [REDAKTUE], në C. [REDAKTUE] (Shqipëri e veriut) në një datë të panjohur në maj apo qershor të vitit 1999.

Është hedhur poshtë në pajtim me nenin 363, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të KPK-së sepse Prokurori i PSRK-së gjatë shqyrtimit kryesor ka tërhequr pikën e Aktakuzës.

Nën pikën e Aktakuzës 2: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve.

I pandehuri X. K. është shpallur FAJTOR,

Sepse ёсhtë dëshmuar se,

Në datën e arrestimit të tij (06.10.2015) në veturën e tij janë gjetur, 7.62 mm revole M56, dhe tri thika, në P. (Kosovë) me datën 06 tetor të vitit 2015.

Duke vepruar kështu, X. K. ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 374, paragrafin 1, në lidhje me nenin 120, pikën 38, të KPRK-së

II.

## I pandehuri X. K. dënohet

## **Nën pikën 1 të Aktakuzës**

## Për akuzën 2

**5 (pesë) vjet burgim;**

### Për akuzën 3

**6 (gjashtë) vjet burgim;**

Për akuzën 4

**7 (shtatë) vjet burgim;**

### **Për akuzën 5**

**6 (gjashtë) vjet burgim;**

### **Për akuzën 6**

**6 (gjashtë) vjet burgim;**

### **Për veprën penale 2**

**Me gjobë prej 1.500 € (një mijë e pesëqind euro)**

**Në pajtim me nenin 80, të KPK-së**

**I pandehuri X. K.** dënohet me një dënim të përgjithshëm prej 8 (tetë) vitesh  
dhe me gjobë prej 1.500 € (një mijë e pesëqind euro).

**Në pajtim me nenin 83, paragrafin 1, të KPK-së**

Koha e kaluar në paraburgim si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë në lidhje ne veprat penale që  
nga 06 tetori i vitit 2015 e deri më sot janë të përfshira në burgim.

### **III.**

### **Sendet e konfiskuara**

Gjërat sikurse më poshtë përkohësisht të konfiskuara më anën ë Aktvendimit të Gjyqtarit të  
procedurës paraprake, data, 12 tetor 2015.

1. Revole M57 7.62 Kal. Ser Nr. 19Z45Z;
2. 2 karikatorë me gjithsej 19 plumba;
3. Një revole “Holstare”;
4. Një thikë paluese me ngjyrë të zezë;
5. Një thikë paluese me ngjyrë të gjelbër;
6. Një thikë shumë pjesësh e kuqe;

do të shkatërrohen në pajtim me nenin 115, paragrafin 5, të KPK-së

## **IV.**

### **Palët e dëmtuara**

Trupi gjykues thekson se palët e dëmtuara nuk kanë parashtuar kërkesën për kompensim gjatë shqyrtimit kryesor. Ata udhëzohen se mund të ndjekin kërkesën e tyre në kontest civil.

## **V.**

### **Shpenzimet e procedurave**

Në pajtim me nenin 453, paragrafin 1, të KPK-së, i pandehuri do të rimbursojë shpenzimet e procedurave penale në shumën e caktuar prej 2.000 € (dy mijë euro).

**Mitrovicë, 08 gusht 2016.**

---

**Kryetarja e trupit gjykues**  
**Katrien Gabriël Witteman**

---

**Anëtare i trupit gjykues**  
**Iva Niksic**

---

**Anëtar i trupit gjykues**  
**René van Veen**

---

**Zyrtarja regjistruese**  
**Chiara Tagliani**

**Këshilla Ligjore:** Në pajtim me nenin 380, të KPK-së, ankesa kundër Aktgjykimit mund të bëhet brenda 15 ditësh pas dorëzimit të kopjes së Aktgjykimit. Ankesa duhet të i adresohet Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore të Mitrovicës.